

# VEPRIMTARIA E AWEN

RRJETI I FUQIZIMIT TË GRUAS NË  
SHQIPËRI



2017



**PROGRAMI "MBROJTJA DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË GRAVE NË SHQIPËRI" 2016 – 2018**, mbështetur nga Sida - Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Objektivi i përgjithshëm i programit: Përmirësimi i pozitës dhe situatës së grave në lidhje me të drejtat e tyre në Shqipëri, nëpërmjet mbështetjes financiare për organizatat anëtare të AWEN, të fokusuar në projekte që kanë të bëjnë kryesisht me:

- ◆ këshillim psiko-social për gratë në nevojë, viktime të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore;
- ◆ strehim, rehabilitim, dhe shërbimet ri-integruese për gratë në nevojë;
- ◆ ndihmë ligjore falas për gratë dhe vajzat në nevojë;
- ◆ fushata advokuese dhe aktivitete në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave njerëzore të grave;
- ◆ ndërgjegjësim dhe informim i komuniteteve lokale lidhur me të drejtat njerëzore të grave.

**Si rezultat i këtij programi dhe mbështetjes së projekteve të zbatuara nga organizatat anëtare gjatë vitit 2016:**

- ◆ Kanë marrë mbështetje nëpërmjet: shërbimeve akomoduese 91 gra e 39 fëmijë; asistencë psikologjike për 1152 vajza e gra; asistencë/shërbime ligjore për 466 vajza e gra; shërbime ri/integruese për 35 vajza e gra; ngritje kapacitetesh për 315 gra; Në total **1880** vajza e gra; 19 burra dhunues kanë marrë shërbimi psikologjike rehabilituese.
- ◆ Janë ngritur kapacitetet e **978** përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe strukturave vendore

**NJË HISTORI SUKSESI gjatë vitit të II-të të zbatimit të programit 3-vjeçar të AWEN/Sida**

Shoqata 'Agritra Vizion' Peshkopi, organizatë anëtare e AWEN, në kuadër të mbështetjes nga AWEN/Sida, gjatë viti 2017 shtoi ndërhyrjet e saj në territorin e Bashkisë Dibër për krijimin dhe forcimin e mekanizmave mbrojtës vendorë për vajzat dhe gratë e dhunuara. Pas një procesi të gjatë advokues dhe lobues, përkrah Organizatës 'World Vision' u mundësua hapja e Strehëzës së Emergjencës në bashkinë e Peshkopisë. Hapja e Strehëzave të Emergjencës është një nga prioritetet kryesore të Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore 2017-2020, hartuar konform prioritetëve të Konventës së Stambollit. Gjatë vitit 2018, me mbështetjen e AWEN/Sida, Agritra- Vizion do të ofrojë mbështetje me shërbime psiko-sociale për vajzat dhe gratë që do të strehohen në këtë strehëz.

nëpërmjet trajnimeve dhe seancave ndërgjegjëse;

- ◆ Rreth **229** të rinj janë angazhuar si aktivistë/praktikantë pranë organizatave anëtare; rreth **1194** aktorë vendorë janë përfshirë në aktivitete fuqizuese e ndërgjegjëse;
- ◆ Janë ndërgjegjësuar lidhur me të drejtat e grave dhe vajzave nëpërmjet fushatave ndërgjegjëse rreth **4946** persona, djem dhe burra, vajza dhe gra;
- ◆ Rreth 15 djem dhe burra dhunues kanë marrë shërbime rehabilituese, kryesisht këshillim psikologjik;
- ◆ Rreth **2881** vajza e gra prej tyre kanë marrë këshillim nëpërmjet telefonit nga organizatat anëtare, ndërmjet tyre 461 janë referuar tek Mekanizmat e Referimit;
- ◆ Si rezultat i punës advokuese dhe bashkëpunimit mes SHC, **është zyrtarizuar ngritja e Strehëzës së Emergjencës në Qarkun Dibër;**
- ◆ Është mbështetur krijimi i **4 Mekanizmave të rinj Referimi** kundër Dhunës në Familje në njësitë administrative Finiq, Konispol, Malësi e Madhe dhe Vau i Dejës.

**FUQIZIM I AWEN & ANWTAREVE**

- ◆ Përgjatë gjithë vitit: Hartimi i Planeve Strategjike dhe dokumenteve të tjerë të zhvillimit organizativ për anëtarët e AWEN;
- ◆ Mars: Trajnim rreth Marrëdhënieve me Publikun (PR) për AWEN & organizatat anëtare;
- ◆ Qershor: Shkëmbim eksperiencash mes anëtareve të AWEN në Vlorë, rreth ndërhyrjeve parandaluese, rehabilituese dhe ri/integruese që ofrohen kundër dhunës me bazë gjinore;
- ◆ Tetor: Workshop 3-ditor rreth RBM – Menaxhimit të Bazuar në Rezultate, për AWEN & organizatat anëtare;

**Gjatë vitit 2017, përveç programit të mbështetur nga Qeveria Suedeze, AWEN ka zbatuar disa projekte të tjera, si:**

**Projekti:** "Fuqizimi i qytetarëve vulnerabël lidhur me aksesin e tyre në drejtësi", zbatuar në partneritet me SSCI dhe mbështetur nga **Koalicioni "Drejtësi për të Gjithë"**

- Qindra qytetatë janë informuar rreth aksesit në drejtësi, nëpërmjet Këndeve Informuese pranë gjykatave në 7 qarqe dhe shpërndarjes të fletëpalosjesjeve informuese (Maj-Dhjetor);
- 20 Juristë janë aftësuar lidhur me aksesin në drejtësi për grupet e pafavorizuara nëpërmjet trajnimit për trajnerë 2-ditor organizuar në Tiranë (Qershor).
- Rreth 60 juristë (Durrës, Pogradec, Shkodër, Vlorë) kanë qenë pjesë e trajnimeve për juristë rreth aksesit në drejtësi për grupet e pafavorizuara dhe rolit të juristëve (tetor);
- Rreth 100 studentë të Fakulteteve të Drejtësisë në Tiranë dhe Vlorë janë informuar e paftësuar për parandalimin dhe masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, përmes ëorkshopeve me studentë dhe gjyqeve imituese, (Nëntor-Dhjetor);

**Projekti:** "Advokim për barazinë gjinore dhe proceset e integritimit në BE", mbështetur nga **Kvinna till Kvinna**

- Rreth 15 përfaqësues të organizata të shoqërisë civile ishin pjesë e trajnimit lidhur me EU Acqui dhe barazinë gjinore (Qershor);
- 18 studentë të gazetarisë u aftësuan rreth njohjes së stereotipeve gjinore në media, legjisllacionit dhe protokolleve të BE-së lidhur me raportimin e ndjeshëm gjinor, gjatë një trajnimi të zhvilluar në Mars;
- Qindra nxënës u bënë pjesë e aktiviteteve dhe minikonkurseve nëpër shkolla në 12 qarqet e vendit, gjatë aktiviteteve zbatuar nga organizatat anëtare të AWEN (Nëntor-Dhjetor);
- AWEN dhe organizatat anëtare hartuan një Strategji për Advokimin me BE (Tetor) lidhur me të drejtat e grave e vajzave.

**Projekti "Rezoluta 1325: Të Drejtat e Grave - Koncepti në Realitetin botëror dhe realitetin Shqiptar", zbatuar në partneritet me "ShGPS, Durrës dhe mbështetur nga Fondi për Barazi Gjinore i UN Women**

- Konferencë Kombëtare për Paqen dhe Sigurinë
- Aktivitete/Takime ndërgjegjësuese
- Takime advokuese rreth hartimit e zbatimit të Rezolutës 1325

**Projekti:** "Fuqizimi i vajzave e grave si agjente ndryshimi në bashkitë Krujë, Fushë-Krujë, Lezhë, Divjakë dhe Ulëz", mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë

- Rreth 80 vajza e gra të Krujës dhe Lezhës kanë qenë pjesë e forumeve lidhur me problematikat që i prekin vajzat e gratë më këto bashki (Dhjetor). Kjo nismë synon të ngrëjë grupe aktive grash në bashkitë e synuara me qëllim mbrojtjen e promovimin e të drejtave të grave.

**Projekti:** "Ndërtimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020", zbatuar në partneritet me GADC, me mbështetjen e **UN Women** dhe financuar nga Komisioni Evropian.

- Dhjetëra OSHC në bashkitë Elbasan, Vlorë, Korçë, Durrës dhe Shkodër ishin pjesë e sesioneve informimuese me temë "Monitorimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020" (Dhjetor).

## FUSHATA NDËRGJEGJËSUESE

### Mars 2017 – Muaji i Gruas & Dita Ndërkombëtare e Gruas

- Forume me studente rreth barazisë gjinore gjatë Muajit Ndërkombëtar të Gruas (Mars);
- Manifestim paqësor ndërgjegjësues në sheshin Nënë Tereza, me mbulim të gjërë mediatik dhe replikim në disa qytete të tjera, më 8 mars 2017, me tematikën #UnëJamSupergrua
- 30 Mars – Ekspozitë me temë “Të Guximshme për Ndryshim” më qëllim njohjen e punës së organizatave të grave në të gjithë vendin në ndihmë e mbështetje të vajzave e grave. Ekspozita u replikua edhe gjatë 16 ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me bazë Gjinore në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë.



### Fushatë Kombëtare ‘T’I JAPIM FUND DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE’

16 Ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore: 25 Nëntor–10 Dhjetor 2017

AWEN dhe 9 organizatat anëtare hartuan një kalendar të ngjeshur me **më shumë se 70 aktivitete ndërgjegjësuese në të gjithë vendin**. Aktivitetet, të mbështetura kryesisht nga donatorë të AWEN gjatë 2017, por jo vetëm, ishin të shumëllojshme, si:

- Forume/Seminare rreth dhunës me bazë gjinore e pabarazive gjinore me nxënës e studentë;
- Fushatë online ‘Dalloje dhunën para se të nisë – 16 ditë, 16 shenja paralajmëruese’;
- Shpërndarje materialesh ndërgjegjësuese, kontakt derë më derë në terren/ zona rurale;
- Pjesëmarrje në emisione televizive e radiofonike në Tiranë e rrethe;
- Takime/biseda të hapura me të rinj, aktivistë e profesionistë rreth dhunës me bazë gjinore;
- Evente artistike e sportive ndërgjegjësuese;
- Fushatë në shkolla nëpërmjet mbështetjes së miniprojekteve rreth barazisë gjinore;
- Ekspozitë informuese rreth shërbimeve e punës së organizatave të grave;
- Aktivitete informuese e kapacitet-ngritëse me studentë rreth legjislacionit për dhunën;
- Takime e mbledhje me aktorë kyç në mbrojtje e mbështetje të të mbijetuarave të dhunës;
- Kënde informuese rreth aksesit në drejtësi, me fokus dhunën në familje;
- Ngritje kapacitetesh lidhur me komunikimin me dhunuesit dhe trajtimin e tyre;
- Ngritje kapacitetesh rreth raportimit të ndjeshëm gjinor me profesionistë të medias;
- Ngritje kapacitetesh rreth dhunës me forcat e rendit;
- Ndërgjegjësim nëpërmjet kinematografisë #MoviesThatMatter;
- Performanca në rrugë (street activism) nga të rinjtë në qytete të ndryshme;
- Forume ndërgjegjësuese me vajza e gra;
- Tubime paqësore në rrethe;
- Ngritje kapacitetesh me vajza e gra vulnerabël;



## KONTRIBUTE NË LOBIM DHE ADVOKACI

- AWEN është pjesë e grupit të punës në hartimin, finalizimin dhe hyrjen në fuqi të Planit të Veprimit për Rezolutën 1325;
- AWEN si anëtar i Koalicionit Drejtësi për të Gjithë - Kontribute për paketën ligjore të Reformës në Drejtësi lidhur me Ligjin për Ndihmën Ligjore Falas;
- Kontribute për Raportin e Delegacionit i BE-së në Shqipëri për vitin 2017, lidhur me të drejtat e vajzave e grave dhe përfaqësim i organizatave të grave në dëgjesat e KE-së në Bruksel;
- Pjesëmarrje dhe kontribut në dëgjesat/seancat e Kuvendit rreth Dhunës ndaj Vajzave e Grave;
- Kontribut në tryezat e njëpasnjëshme të organizuara nga Këshilli i Evropës rreth funksionimit të sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe antidiskrimimit;
- Kontribut në takimin konsultues me përfaqësues të komitetit GREVIO të organizuar në Tiranë; etj.

## Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare:

- Maj 2016: Pjesëmarrje në Workshopin rreth Raportimit Hije për Konventën e Stambollit, organizuar nga WAVE- Rrjeti Evropian kundër Dhunës ndaj Grave, në Vienë, Austri;
- Nëntor 2016: Pjesëmarrje në takimin me OShC-të e grave për themelimin e Grupit të Ekspertëve Rajonalë (REWG) mbi Çështjet Ndër-seksionale, në kuadër të programit të BE-së dhe OKB-së "Zbatojmë Normat, Ndryshojmë Mendjet", në Stamboll, Turqi;
- Tetor 2017: Pjesëmarrje në FREJA Forum, Suedi.
- AWEN merr pjesë për të pestin vit në takime konsultuese me DG NEAR (Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit), përfaqësues të Parlamentit Evropian Në kuadër të projektit rajonal të mbështetur nga Kvinna till Kvinna

**AWEN falenderon të gjithë bashkëpunëtorët për kontributin e tyre në mbështetje të grave e vajzave në të gjithë Shqipërinë gjatë vitit 2017!**

**RAPORT PËRMBLEDHËS FINANCIAR PËR VITIN 2017**  
Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

Sida	Buxheti (EUR)	Shpenzime (EUR)	Diferenca (EUR)
Kosto Operacionale	55,890.00	52,785.00	3,105.00
Aktivite	34,059.00	19,829.20	14,229.80
Mbeshtetje financiare për anëtarët e AWEN	238,938.00	238,604.00	334.00
<b>TOTALI</b>	<b>328,887.00</b>	<b>311,218.20</b>	<b>17,668.80</b>

Kvinna till Kvinna	Buxheti (EUR)	Shpenzime (EUR)	Diferenca (EUR)
Kosto Operacionale	7,524.00	4,893.24	2,630.76
Aktivite	11,432.00	10,350.77	1,081.23
Transferim i fondeve për anëtarët e AWEN	2,513.00	2,513.00	-
<b>TOTALI</b>	<b>21,469.00</b>	<b>17,757.01</b>	<b>3,711.99</b>

Koalicioni Drejtësi për të gjithë (USAID)	Buxheti (USD)	Shpenzime (USD)	Diferenca (USD)
Kosto Operacionale	12,096.00	5,364.00	6,732.00
Shërbime kontraktuale	16,000.00	9,195.00	6,805.00
Aktivite	20,213.00	9,553.00	10,660.00
Transferim i fondeve për anëtarët e AWEN	4,181.00	4,181.00	-
<b>TOTALI</b>	<b>52,490.00</b>	<b>28,293.00</b>	<b>24,197.00</b>

Rezoluta 1325 UN Women/ AWSP	Buxheti (USD)	Shpenzime (USD)	Diferenca (USD)
Takime ndërgjegjësuese, Tryeza Advokuese	8,972.51	8,317.67	654.84
<b>TOTALI</b>	<b>8,972.51</b>	<b>8,317.67</b>	<b>654.84</b>

Ambasada Amerikane	Buxheti (USD)	Shpenzime (USD)	Diferenca (USD)
Kosto Operacionale	2,805.00	1,296.00	1,509.00
Takime ndërgjegjësuese	7,195.00	1,025.00	6,170.00
<b>TOTALI</b>	<b>10,000.00</b>	<b>2,321.00</b>	<b>7,679.00</b>

UN Women/ GADC	Buxheti (ALL)	Shpenzime (ALL)	Diferenca (ALL)
Takime ndërgjegjësuese	130,000.00	88,000.00	42,000.00
<b>TOTALI</b>	<b>130,000.00</b>	<b>88,000.00</b>	<b>42,000.00</b>

	Shuma ne Euro	Shuma ne USD	Shuma ne ALL
Total Fonde për vitin 2017 në EUR	350,356		
Total Fonde për vitin 2017 në USD		71,462.51	
Total Fonde për vitin 2017 në USD			130,000.00
Fonde të kaluara Organizatave Anëtare	241,117	4,181.00	
<b>Totali i Fondeve sipas monedhës për vitin 2017</b>	<b>591,473</b>	<b>75,644</b>	<b>130,000</b>
Sa % kaluar Organizatave Anëtare	<b>69%</b>	<b>6%</b>	